
**THE ALBANIAN EVANGELICAL CHURCH – A POWERFUL SYMBOL OF
RESISTANCE IN THE TRANSMISSION OF KNOWLEDGE**

Fabiola Kadi

F. S. Noli University, Korça, Albania, fabiola_muco@yahoo.fr

Helona Pani

F. S. Noli University, Korça, Albania, elenipani@yahoo.fr

Abstract : It is a fact that Christianity is deeply rooted in the history of the Albanian nation, but, unfortunately, such a fact has opened the gate to endless discussions. This paper aims to highlight an important event in the history of Albania, which will influence the future history of this nation. During the nineteenth century, Protestants contributed significantly to the Albanian national issue through performing translations of several books of the Bible, at a time when books in Albanian language were very rare. Different foreign missionaries came to Albania to spread their religious views. They strongly influenced the opening of Albanian schools while Albanians, under Turkish rule, were forbidden to use their language, to learn to write, or read it. Gradually, the foreign missionaries were attended by Albanian intellectuals, who insist on the opening of the Albanian school and the education of Albanians in Albanian language. Interestingly, Protestantism was the only religious belief that supported Albanian writing and reading, while other religious beliefs exercised in Albania were the fiery opponents of every Albanian component. The Albanian language on one hand was opposed by the Greek Orthodox Church, on the other hand, by the Latin Catholic Church and above all, Ottoman rule opposed the teaching of the Albanian language in order to keep the Albanian people as subordinate as possible. It seems that Protestantism has emerged in all the countries where it has spread, supporting various national identities, but especially in Albania, it has played an important role in supporting the national identity of Albanians and the education of generations, especially of girls. The opening of the first Albanian girls' school in the city of Korça keeps the seal of the Protestant church and it has had a great impact in the future for the emancipation of Albanian society, of women and girls who are oppressed and printed in many directions. Sevasti Qiriazhi, as a representative of the Protestant church in Korça, and the first teacher in Albania, will protect the school and try to support the spread of the Albanian language at all costs. Through the spread of faith in Albanian, the first Protestants in Albania conveyed not only knowledge, but also great human, moral, and educational values to people who were suffering, but eager for knowledge and development. The Protestant Albanian movement was actually an 'Albanian spiritual movement' with religious, educational, national and cultural values and purposes. For several decades, during the communist regime in Albania, a good part of the influence of protestants in the country was denied and all efforts were made to overshadow the influence of Protestantism towards education and emancipation of Albanians in this period. Today, after many years of shadow, Protestantism is again one of the religions that are practiced in Albania and numerous efforts are being made to discover many of the unknown elements of the positive influence that this belief had in educating Albanians over the years.

Keywords: Education, Emancipation, Protestantism, Knowledge, Values

**KISHA UNGJILLORE E SHQIPËRISË, NJË HISTORI E MAHNITSHME QËNDRESE
NË TRANSMETIMIN E NJOHURIVE**

Fabiola Kadi

Universiteti F. S. Noli, Korçë, Shqipëri, fabiola_muco@yahoo.fr

Helona Pani

Universiteti F. S. Noli, Korçë, Shqipëri, elenipani@yahoo.fr

Abstrakt: Krishtërimi i ka rrënjët shumë thellë në historinë e Shqipërisë, edhe pse për fat të keq ky fakt ka shkaktuar diskutime të shumta. Në këtë punim jemi përqendruar tek një moment në historinë e Shqipërisë i cili do të ndikojë në historinë e mëvonshme të këtij vendi: gjatë shekullit XIX, protestantët dhanë një kontribut të rëndësishëm për çështjen kombëtare shqiptare, përmes përkthimit të pjesëve të ndryshme të Biblës ndërkohë që kishte shumë pak libra të botuar në gjuhën shqipe. Misionarë të ndryshëm të huaj erdhën në Shqipëri për të përhapur pikëpamjet e tyre fetare. Ata ndikuan fuqishëm në hapjen e shkollave shqipe ndërkohë që shqiptarët, nën sundimin turk e kishin të ndaluar të përdornin gjuhën e tyre, të mësonin ta shkruanin apo ta lexonin atë. Pak e nga pak misionarët e huaj u ndoqën nga intelektualë shqiptarë, të cilët kërkonin me ngulm hapjen e shkollës shqipe dhe edukimin e shqiptarëve

ne gjuhën shqipe. Është interesant fakti që protestantizmi ishte i vetmi besim fetar që mbështeste shkrimin dhe leximin shqip, ndërkohë që besimet e tjera fetare që ushtroheshin në Shqipëri ishin kundërshtarë të zjarrit të çdo elementi kombëtar shqiptar. Shqipja nga njëra anë kundërshtojë nga kisha orthodhokse greke, nga ana tjetër, nga kisha katolike latine dhe mbi të gjitha sundimi osman e kundërshtonte mësimin e gjuhës shqipe për ta mbajtur sa më gjatë nën zgjedhë popullin shqiptar. Duket se protestantizmi ka shfaqur në të gjitha vendet ku është përhapur, përkrahje ndaj identiteteve të ndryshme kombëtare, por veçanërisht në Shqipëri, ai ka luajtur një rol të rëndësishëm për mbështetjen e identitetit kombëtar të shqiptarëve dhe edukimin e brezave, e në veçanti të vajzave. Hapja e shkollës së parë shqipe të vajzave në qytetin e Korçës mban vulën e kishës protestante dhe ajo pati një ndikim të madh në të ardhmen për emancipimin e shoqërisë shqiptare, të grave dhe vajzave të prapambetura e të shtypura në shumë drejtime. Sevasti Qiriazzi, si përfaqësuese e besimit protestant në Korçë dhe gruaja e parë mësuese në Shqipëri do të mbrojë shkollën dhe do të përpikët të mbështesë me çdo kusht përhapjen e mësimin shqip. Përmes përhapjes së besimit në gjuhën shqipe, protestantët e parë në Shqipëri ditën të përçonin jo vetëm njohuri, por edhe vlera të mëdha njerëzore, morale dhe edukative tek një popull i vuajtur, por i etur për dije e zhvillim. Lëvizja protestante shqiptare ishte faktikisht një 'lëvizje shpirtërore shqiptare' me vlera dhe qëllime fetare, arsimore, kombëtare e kulturore. Për disa dekada, gjatë regjimit komunist në Shqipëri, një pjesë e mirë e ndikimit të protestantëve në vend, u mohua dhe u bënë gjithë përpjekjet për të lënë në hije prurjet e protestantizmit në lidhje me edukimin dhe emancipimin e shqiptarëve të kësaj periudhe. Sot, pas shumë vitesh hijeje, protestantizmi është sërish një prej besimeve që praktikohen në Shqipëri dhe po bëhen përpjekje e studime të shumta për të zbuluar shumë elementë ende të panjohur të ndikimit aq pozitiv të këtij besimi në edukimin e shqiptarëve në vite.

Fjalë kyçe: Edukim, Emancipim, Protestantizëm, Njohuri, Vlera

“Jam shqiptare. Ky është fakti më i rëndësishëm i jetës sime, madje më i rëndësishëm se vetë familja ime, sepse ndërgjegjësimi për këtë fakt më tregoi udhën që duhet të ndiqja dhe vendosi qëllimin e jetës sime; ai përcaktoi vendosjen time gjeografike dhe historike dhe u bë burimi i interesit tim kryesor dhe i idealit tim që nga fëmijëria ime për ta pajisur popullin tim me njohuri dhe për të rizgjuar tek ai dashurinë për pavarësinë.”

- Stucky D. & Hosaflook D. (2016), *Jeta ime – jetëshkrimi i pabotuar i “Mësueses së Popullit” Sevasti Qiriazzi-Dako*, ISShP, Tiranë.

1. SHEKULLI XIX DHE GJENDJA E POPULLIT SHQIPTAR

Për shekuj me radhë, gjuha shqipe, edhe pse nuk ka pasur letërsi të shkruar, është ruajtur nga populli me besnikëri, në formën e saj të folur. Shtypja politike, apo intrigat e ndryshme fetare nuk mund të bënin shqiptarët të harronin origjinën e tyre, gjuhën dhe zakonet, historinë e tyre që nga lashtësia. Ata kishin etje për një standard më të lartë të jetës dhe ushqenin një dëshirë të madhe për edukimin kombëtar, i cili dalëngadalë u kthye në një pasion që i hapi rrugën afirmimit kombëtar për liri dhe pavarësi. Megjithatë, hapat drejt rizgjimit ishin të vështirë. Megjithë përpjekjet e shumta, në mungesë të gjuhës së shkruar, të një sistemi shkollor, madje të alfabetit shqip, shqiptarët e kishin të pamundur ecjen përpara dhe fitoren mbi armikun pushtues. Për të arritur të gjitha këto, nevojitej mbështetje nga faktorë të ndryshëm, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Alfabeti për shqiptarët ishte hapi i parë drejt bashkimit të popullit. Meqenëse feja për shqiptarët nuk përbënte një element bashkues, përderisa ata ishin të përçarë në disa besime, rilindasit e shekullit XIX duhet të vinin theksin tek gjuha, zakonet, historia të cilat ishin të përbashkëta. Në Kongresin e Manastirit pati 11 delegatë, përfaqësues të feve të ndryshme. Atje kishte myslimanë, orthodhoksë, bektashinj, katolikë dhe protestantë.

2. VEPRIMTARIA PROTESTANTE NË KORÇË, NDIKIMI

Qysh herët, që prej fillimeve të tij në vendet e Evropës Perëndimore, Protestantizmi është shfaqur si një besim i cili ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimin e besimit të krishterë duke respektuar kulturën vendase, gjuhët kombëtare dhe duke i dhënë dorë zhvillimit të identitetit kombëtar të vendeve në të cilat u përhap. Gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, protestantët themeluan me qindra shkolla për vajza në vende të ndryshme. Edhe protestantizmi shqiptar ka pasur karakteristika të ngjashme me atë evropian dhe kjo duket më së miri në përpjekjet e shumëllojshme të misionarëve të parë protestantë për të përkthyer Biblën në gjuhën shqipe ndërkohë që libri shqip ishte ende thujtë inekzistent. Shoqëria Biblike dhe vepra e saj u vlerësuan shumë mirë nga shqiptarët të të gjitha besimeve. Lëvizja protestante ka luajtur një rol të fuqishëm në zgjimin kombëtar kulturor shqiptar. Ajo pati vlera dhe qëllime jo vetëm fetare, por kombëtare, kulturore dhe arsimore. Përfaqësues të besimit protestant ishin jo vetëm nismëtarët e përkthimeve të Biblës, por edhe ndër ata që kontribuan në mbajtjen e Kongresit të Manastirit për t'u dhënë shqipes dhe shqiptarëve një alfabet. Lëvizja protestante luajti një rol të rëndësishëm në emancipimin e grave. Kulmi i veprimtarisë së tyre për zhvillimin dhe edukimin e brezave të rinj ishte hapja e shkollave shqipe në disa

qytete të Shqipërisë. Falë mbështetjes së protestantëve u botua edhe abetarja e parë shqipe duke e kthyer kështu shkollën në një institucion mbarëkombëtar.⁴⁶ Në këtë punim jemi përqendruar më tepër në zhvillimin e veprimtarisë protestante në qytetin e Korçës, meqenëse është edhe qyteti ku u hap shkolla e parë shqipe.

Në 27 janar 1883, Aleksandër Tomsoni, përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike në Stamboll, aq dashamirës ndaj shtqiptarëve, i shkruan një letër Gjerasis Qiriazit në të cilën, pasi vlerëson përkthimet e Dhjatës së Re dhe Psalmeve në shqip, i shpreh atij shqetësimin për gjendjen e shqiptarëve të paarsimuar dhe nevojën e ekzistencës së një shkolle shqipe : « *Kur mendoj për gjendjen në të cilën ndodhen shqiptarët, më duket se për ta është domosdoshmëri e madhe të kenë shkolla ku fëmijët të mësojnë gjuhën amtare me Fjalën e Perëndisë...* »⁴⁷

Ndërsa vetë Gjerasisi shkruante në librin e tij : “*Në gjendjen në të cilën gjendet sot gjuha jonë, çdo libër që del me gëzim këndohet prej më së madhes pjesë të kombit tonë. Më duket se, sot për sot, më i madhi shërbim që mund t’i bëhet kombit tonë është : t’i jepet ndonjë libër i ri në dorë, sepse faqeja duket që uria është e madhe.*” – (Gjerasis Qiriaz, Hristomathi, 1902)

3. « SHKOLLA E VASHAVE » - NJË PISHTAR I NDEZUR NË MES TË ERRËSIRËS

Një nga familjet e cila spikati në përçimin e edukimit përmes shpërndarjes së librave, mbështetjes së fuqishme ndaj arsimimit shqip dhe edukimit të brezave, ishte familja Qiriaz. Gjerasisi, Gjergji dhe motrat Sevasti dhe Parashqevi Qiriaz ishin të rinj të rritur me ndjenjën atdhetare dhe krenarinë për vlerat e kombit shqiptar. Të ushqyer që në djep me atdhedashuri, ata nuk harruan nevojat e shqiptarëve për dritën e dijes dhe arsimin. Motrat Qiriaz, Sevastia dhe Parashqevia u arsimuan pikërisht në një prej këtyre shkollave, në Manastir.

Me këto mësim të vyera, ato u frymëzuan dhe i vunë detyrë vetes të punonin për lartësimin e gruas shqiptare. Kështu, Sevastia u bë e para femër shqiptare e diplomuar në një shkollë të lartë dhe e para drejtoreshë në një shkollë shqiptare, ndërsa Parashqevia ishte e vetmja grua shqiptare e pranishme në Kongresin e Manastirit, e para grua shqiptare që hartoi një tekst shkollor, e para e diplomuar nga dy universitete, e para kryeredaktore e një periodiku dhe e para delegate shqiptare në një konferencë ndërkombëtare (Konferenca e Paqes në Paris). Për Parashqevinë, « arsimi e mbron lirinë më mirë se një ushtri »⁴⁸.

Ndërsa koncepti i saj për emancipimin e gruas shqiptare duket detyra që i ka vënë vetes : “Duhet të gdhijë një ditë me dritë edhe për gratë, se themeli i një kombi qëndron mbi arsimin e gruas.”

Edhe Edith Durhami, “mikesha e madhe e Shqipërisë” e vlerësoi shumë lart veprën e kryer nga protestantët në Shqipëri, nga kisha protestante e në veçanti nga shkolla e Vashave në Korçë. Ajo çmoi mbi të gjitha punën e kryer për emancipimin e grave në Shqipëri si edhe për arsimin në përgjithësi. Ajo që është vlerësuar edhe nga bashkëkohësit, edhe pse një pjesë e mirë, me besime të ndryshme, është puna e Misionit Ungjillor, të cilët përmes veprës së tyre nuk kishin synime të fshehta politike përçarëse siç ndodhte me përfaqësues të besimeve të tjera që vinin në Shqipëri. Menjëherë pas përfundimit të Kongresit të Manastirit delegatët vizituan Shkollën e Vashave në Korçë dhe dihet se delegatët ishin përfaqësues të besimeve të ndryshme.

Ndërsa vizitoi Shqipërinë në 1863, Aleksandër Tomsoni vërejti mungesën e arsimimit të vajzave dhe ai personalisht mbështeti fuqishëm mësimdhënien në gjuhën shqipe në shkollën e Vashave në Korçë dhe mësuesen Sevasti Qiriaz. Interesante është se ky interes i Aleksandër Tomsonit për hapjen e një shkolle shqipe, përkon në të njëjtin moment me interesimin e të riut Gjerasis Qiriaz për të bërë diçka për bashkëkombësit e tij. Dhe thuhet se madje letrat e tyre drejtuar njëri-tjetrit janë dërguar në të njëjtën kohë. Gjerasis Qiriaz, pasi u emërua ungjilltar për vendin e vet, u nis për në Korçë në vitin 1890 dhe filloi të predikonte ungjillin. Kjo shënoi fillimin e një epoke të re, ndërsa pak e nga pak Korça po kthehej në qendrën e Lëvizjes Protestante. Gjerasisi i mbajti një pjesë të mirë të predikimeve të tij në shkollën e parë shqipe “Mësonjëtorë”, e cila ishte hapur në vitin 1887. Kur kleri grek e mori këtë informacion, filloi të merrte masa për ta kundërshtuar këtë fakt.

Vëllezërit dhe motrat Qiriaz bënë përpjekje maksimale në përmirësimin e kushteve të jetesës së shqiptarëve e sidomos të korçarëve, qytet në të cilin ata jetuan e dhanë kontributin e tyre për një kohë të gjatë. Sevasti Qiriaz ishte ndër gratë e para që u arsimua jashtë vendit, e cila u kthye në Shqipëri për të mbështetur vendin e saj dhe për të ndikuar sadopak në zhvillimin e kulturës dhe edukimit shqip. Sevasti Qiriaz shfaqti që herët ndjenjat e saj atdhetare e patriotike dhe iu përkushtua edukimit të të rejave korçare. Ajo ishte ndër të parat që përgatiti tekstet e para shkollore në Shqipëri dhe dha kontributin e saj në standardizimin e alfabetit shqip. Ajo edukoi breza të tërë mësuesish dhe ndikoi në emancipimin e vajzave korçare si edhe bashkëveproi në krah të atdhetarëve të tjerë

⁴⁶ Grup autorësh, (2017), *Libri shqip dhe veprimtaria protestante – 200 vjet rrugëtim kulturor*, IAPS, Tiranë.

⁴⁷ Ibid.

⁴⁸ Ibid.

shqiptarë për çlirimin e vendit nga pushtimi osman. Në kujtimet e saj, ajo shprehet se qëllimi i jetës së saj ka qenë « të ndriçojë, të lartësojë dhe të shpëtojë njerëzit nga zgjedha e injorancës dhe besëtytnisë. »⁴⁹ Ajo u kthye në simbol të reformës arsimore, patriotizmit dhe vetësakrificimit. Një nga qëllimet kryesore të jetës së saj ishte mundësia e arsimit për femrat e shtypura të vendit të saj. E gjendur në një atmosferë kundërshtish politike dhe fetare, e përplasur me disa ndodhi politike që kanë ndikuar në jetën shoqërore të vendit, asaj iu desh të ushqente shpirtin e saj me dashuri për atdheun dhe ndihmesën ndaj bashkëkombësve të saj. Synimi dhe objektivi i saj është të ngrejë popullin e saj drejt shkollimit dhe pavarësisë, drejt emancipimit dhe kërkit të lirisë. Sevastia ishte ndër ato mësuese që vlerësonte karakteristikat e popullit të saj, i cili, edhe pse ishte i paarsimuar, kishte virtyte të larta për të cilat duhej vlerësuar. Në luftë për shkombëtarizimin e vendit nga turqit, zërat e Sevastisë dhe patriotëve të tjerë dëgjohen ndjeshëm për të rizgjuar shqiptarët dhe që të arrihej ky qëllim, patjetër ishte e nevojshme që ata të edukoheshin dhe shkolloheshin me qëllim që të luftonin paditurinë përmes dëgjimit, errësirën përmes dritës. Për shkak se ka udhëtuar mjaft, Sevastia është në gjendje të bëjë krahasime mes pozicionit të gruas në familjen shqiptare dhe në vendet e tjera që ajo ka vizituar. Ndërsa përballet me pozicionin e gruas shqiptare në shoqëri, Sevastia nuk mund të lërë pa vlerësuar rolin e rëndësishëm të gruas në familje dhe në vendimmarrje, por nga ana tjetër ajo është e vetëdijshme për rolin edhe më të madh që mund të luajë gruaja shqiptare nëse edukohet me vlerat arsimore. Ajo e njeh mirë vlerën e vërtetë të shkollimit dhe nevojën për të punuar për ndriçimin dhe rizgjim të popullit shqiptar, i cili për shkak të mungesës së lirisë për t'u edukuar në gjuhën shqipe, nuk është në gjendje të luftojë, me armët e duhura : ato të edukimit. Ndërsa përçonte këto vlera te nxënëset e saj, këto mësimet do të hidhnin rrënjë të thella dhe do të jepnin fryte vite më vonë.

4. EDUKIMI PËRMES BESIMIT

Shkolla e Vashave, themeluar nga Gjerashim dhe Sevasti Qiriaz, u shqua për rolin e saj emancipues për femrën shqiptare. Ajo u çel në 23 tetor 1891 duke pasur në themel pak libra dhe burime financiare shumë të kufizuara. Si model për ecurinë e shkollës, Sevastia ndoqi modelin e shkollave protestante, të cilat ishin shumë të zhvilluara dhe me baza të shëndosha pedagogjike. Ajo diti t'ia përshtasë këtë model mjedisit shqiptar, duke pasur parasysh gjithnjë nivelin e vajzave dhe grave me të cilat punonte. Mësimi zhvillohej në shqip dhe shumë shpejt kjo shkollë fitoi simpatinë e qytetarëve korçarë e jo vetëm. Shpesh thuhet se shkolla e Vashave ishte laike. Në të vërtetë, ajo ishte një shkollë me drejtim të theksuar ungjillor, pasi përveç lëndëve të ndryshme që zhvilloheshin, kishte edhe lëndë tërësisht fetare dhe çdo ditë mësimi fillonte me lutje dhe lexime nga pjesë të Biblës. Interesant është fakti që pavarësisht drejtimit të saj ungjillor, kjo shkollë mbledhi pranë vetes vajza të besimeve të ndryshme pa dallim, myslimane e të krishtera.

Gjerashim Qiriaz, i cili mbështeste vazhdimisht shkollën, ndërsa e kuptonte fare mirë rëndësinë e edukimit, nuk mund të nënvlerësonte rëndësinë e madhe të Ungjillit në jetën e shqiptarëve. Për të, Shqipëria do të mund të ndryshonte përmes bashkërendimit të dy elementeve : besimit dhe edukimit.

“Njohuria nuk mund të sjellë ndonjë gjë të madhe pa Ungjillin, sepse ka njerëz të ditur që janë më të këqinj të botës. Nga ana tjetër, dituria dhe Ungjilli, të dyja bashkë kanë sjellë rregull në botë... Nga një njeri që ka frikë Perëndinë nuk mund të presësh veçse të mirën... Dihet pra, që dituria pa Ungjillin nuk mund t'i sjellë botës të mirën e shkëlqesë të keqes dhe të bashkojë zemrat e njerëzve në një dashuri të përsosur.”

Gjerashim Qiriaz botoi edhe veprën *Hristomathi*, me qëllim që të përdorej në shkollat shqiptare me poema, këngë, dialogë dhe lexime. Në fund të shkrimit, autori përfundon me një lutje e cila shpreh aspiratat e tij si intelektual dhe atdhetar :

« Dhashtë Zoti, çdo bir e bijë e Shqipërisë

T'i bëhet me gjithë zemër rob urtësisë. »

Pyetja që shtronte shpesh Qiriaz përmes shkrimeve të tij ishte :

“A mundet bota të përmirësohet vetëm me arsimin pa Ungjillin?”

Dy vjet pas hapjes së shkollës, Gjerashimi vdes dhe drejtimi i shkollës mbetet vetëm në duart e Sevastisë. Ajo do të bashkëpunojë me urtësi me patriotët të tjerë dhe do të bëjë përpjekje në të gjitha drejtimet që punët e shkollës e të shqiptarisë të ecin përpara. Shumë intelektualë shqiptarë, atdhetarë, në përpjekjen për rizgjim kombëtar, herë do të shfaqen si predikues e shpërndarës librash, e herë të tjera si patriotë e mësues. Duket se protestantët kishin dy moto kryesore: Shqiptarinë dhe Ungjilli. Thuajse të gjithë, paraqesin këtë ide në lidhje me besimin dhe atdhedashurinë, ata nuk shohin asnjë kundërshti mes këtyre dy elementeve. Përkthimet e shkrimeve të shenjta, shërbesave dhe liturgjisë në gjuhën shqipe, ishin disa nga ndihmesat më të mëdha të protestantëve shqiptarë, apo të huaj të kësaj periudhe. Të

⁴⁹ Stucky D. & Hosaflook D. (2016), *Jeta ime – jetëshkrimi i pabotuar i “Mësueses së Popullit” Sevasti Qiriaz-Dako*, ISShP, Tiranë.

gjitha këto përpjekje nxjerrin në pah konceptin protestant në lidhje me marrëdhënien mes laikes dhe biblike. Protestantizmi në Shqipëri i pajtoi me njëra-tjetrën vlerat e traditës biblike me atë laike.

Ajo u kthye në një “fole kombëtare”, një vatër patriotike e institucion kombëtar. Edhe pse u bënë përpjekje për ta mbyllur shkollën, ajo qëndroi e hapur edhe kur shkolla të tjera shqipe u mbyllën në vitin 1902. Historia e saj është një histori e mbushur plot aventura e ndodhi të shumëllojshme për shkak të kushteve shoqërore dhe politike të kohës. Është historia e ndeshjes së diturisë kundër injorancës, përndjekjes, tiranisë dhe besëtytnisë. Shkolla e Vashave në Korçë u quajt ndryshe edhe “Pishtar flakëruës” sepse populli e vlerësonte për qëndrimin e lartë moral. Porta e hekurt e paditurisë ishte rrëzuar dhe tani mund të hynte begatia dhe lumturia.

Pas pesë shekujsh lufte të mundimshme, dukej se populli shqiptar kishte filluar të merrte frymë lirisht dhe të shijonte bekimin e shkollimit.

5. HISTORIA E SHKOLLËS SHQIPE – NJË HISTORI PËRPLASJESH TË MUNDIMSHME

Në vitin 1913, me pushtimin grek dhe shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, shkolla e Vashave në Korçë u mbyll përkohësisht për t’u rihapur më vonë nën drejtimin e misionarëve protestantë amerikanë, çiftit Violet dhe Fineas Kenedi duke u quajtur Shkolla Amerikane, ndërkohë që motrat Qiriazhi ishin në Amerikë. Kur ato u kthyen, punuan në Kamzë dhe hapën një shkollë që do të ecte në të njëjtën frymë me Shkollën e Vashave, “Institutin Qiriazhi”. Ky institut u vlerësua nga patriotët shqiptarë si “fole kombëtare” dhe në 40 vjetorin e tij morën pjesë figura të shquara të kohës. Vlen të citohet fjalimi i mbajtur nga Aleksandër Xhuvani:

“Puna që shkolla e Kyriazit ka punue në gjithë jetën e saj për edukimin e vajzës shqiptare e ngren atë nalt në ndërgjegjë të çdo Shqiptari, që mendon se edukata e gruas shqiptare asht themeli i edukatës shoqërore, themeli i përparimit t’onë si Shtet e si komb. Por edhe për një tjetër gjë ka randasi vepra e kësaj shkolle, pse këtë edukatë të vajzës shqiptare e ka dhanë në gjuhë amtare, në një kohë kur ishte i ndaluem zyrtarisht përdorimi i gjuhës s’onë si vegël mësimi.”

Shkolla amerikane u mbyll në vitin 1933 dhe misionarët amerikanë u detyruan të largoheshin. Misionarët e fundit nga Korça u larguan në vitin 1940 duke mos e ditur se nuk do të mund të ktheheshin më në Shqipëri pa kaluar 50 vite. Që prej vitit 1934, kishës ungjillore do t’i duhej të përballej me një kundërshtar të fuqishëm : Komunizmin.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria pushtohet nga Gjermania dhe Italia dhe shqiptarëve do t’u duhet të luftojnë si politikisht, ashtu dhe ushtarakisht. Lëvizja komuniste ishte ajo që udhëhoqi shqiptarët drejt çlirimit dhe, në përfundim të Luftës, në vitin 1944, Shqipëria u zyrtarizua si vend komunist. Fillimisht feja u lejua, por filloi të ushtrohej një kontroll i rreptë ndaj institucioneve fetare. Në vitin 1967, feja u ndalua plotësisht dhe në vend të fesë, vendin e zuri adhurimi për udhëheqësin politik të kohës. Feja u konsiderua si e pabazë shkencërisht, madje antishkencore dhe përfaqësuesit e saj si antikombëtarë. Përfaqësues të besimeve të ndryshme që ishin ushtruar në Shqipëri, tashmë përndiqeshin e persekutoheshin. Misionarët protestantë u quajtën “agjentë të spiunazhit amerikan”. Protestantët përgjoheshin dhe u bënë përpjekje për ta shpërbërë plotësisht veprimtarinë e tyre. Ndërsa familja Qiriazhi, për shkak të lidhjeve me amerikanët, u konsiderua si kërcënim dhe nuk u mor parasysh asnjë nga përpjekjet e tyre për kombin për vite të tëra. Besimi tashmë nuk mund të ushtrohej lirisht dhe ata që vazhdonin ta praktikonin, duhej ta bënin këtë gjë në mënyrë të fshehtë, në të kundërt rrezikonin lirinë, apo edhe jetën. E mëgjithatë, me rënien e komunizmit, pas viteve ’90, situata ndryshon plotësisht dhe Shqipëria kalon përmes një rizgjimi tjetër, shpirtëror, intelektual, kulturor. Sërish, ndër të parët që trokasën në dyert tashmë të hapura, janë misionarë protestantë, të cilët vijonë për të rigjetur zemrat hapur të shqiptarëve. Ata vijnë sërish me Bibla të përkthyer në shqip, të cilat tashmë i shpërndajnë pa frikë në duart e shqiptarëve të etur për të ditur më tepër, për të qenë të lirë të zgjedhin. E ndërsa besimi protestant rizgohet, edhe vlerësimi për familjen Qiriazhi merr një kuptim të ri. Shumë studiues interesohen hapur për veprën e tyre e nuk ekziston më frika për të vlerësuar përkushtimin dhe sakrificën e tyre. Me rastin e 500-vjetorit të Reformës protestante, në Shqipëri u organizuan një sërë aktiviteteve kulturore e shkencore, një sërë librash u botuan për të nxjerrë në pah veprimtarinë protestante ndër vite. Në po këtë periudhë, u botua edhe *Jeta ime* e Sevasti Qiriazit, realizuar me aq përkushtim nga një misionare amerikane e cila erdhi në Shqipëri pas viteve ’90 dhe jetoi një kohë të gjatë në qytetin e Korçës.

PËRFUNDIME

Prej fillimit të shekullit XIX-të, një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare dhe shkrimit shqip do të luante një fe e re për shqiptarët, Protestantizmi, i cili i pati fillesat e tij në pjesën jugore të vendit. Lëvizja protestante pati rëndësi jetësore për krahinën e Korçës dhe për zhvillimin kulturor, fetar, historik, gjuhësor dhe letrar të vendit. Protestantët, të mbështetur nga shoqata britanike biblike, mundën të përkthejnë e të botojnë një pjesë të mirë të shkrimeve të shenjta në shqip. Ata ishin ndër më aktivët në hapjen e shkollave shqipe dhe përdorimin e gjuhës shqipe në to, duke sjellë kështu përparimin e Shqipërisë në shumë drejtime. Përmes botimit të librave në

shqip, ata ndezën dashurinë për gjuhën shqipe ndër shqiptarët dhe vendosën alfabetin përfundimtar shqip, përmes botimeve të shumta të tyre. Kështu, theksohet ideja e gjuhës që lidhet me kombin e jo me një fe të caktuar, çka kishte ndodhur deri më tani. Megjithë përpjekjet e shumta të intelektualëve shqiptarë të feve të tjera ekzistuese për përdorimin e gjuhës shqipe, nuk ishin arritur rezultatet që u arritën me krijimin e bashkësisë protestante në Korçë. Shtypshkronja e Manastirit financohej nga një grup myslimanësh të cilët ishin patriotë të fuqishëm. Ajo shpërndante libra dhe gazeta në gjuhën shqipe brenda dhe jashtë vendit. Myslimanët e mbështetnin fuqishëm programin e gjuhës kombëtare të Shoqërisë Biblike dhe bashkëpunonin për të botuar pjesë të Shkrimeve të Shenjta të krishtera në gjuhën shqipe. Kjo mund të duket kontradiktore, por është një dëshmi e gjallë e dashurisë së shqiptarëve për gjuhën shqipe. Aq shumë u kish munguar shqiptarëve shkrimi shqip, saqë para kësaj gjuhe, thyheshin të gjitha ndarjet e dallimet, qoftë edhe ato fetare. Vlerësimin për shkollën e Vashave në Korçë e ka shprehur aq bukur Mihal Grameno teksa shkruante :

“Kurrë nuk duhen harruar shërbimet e mëdha që i ka sjellë çështjes një “fole kombëtare” e cila ishte një qendër dhe një fortesë ku mblidheshin edhe që ku përhapeshin ndjenjat e shkëndijat kombëtare. Kjo fole ishte shkolla e vajzave në Korçë, e themeluar prej të pavdekurit dërgimtar kombëtar Gjasim Qiriaz, emrin e të cilit historia e Shqipërisë do ta shkruajë me shkronja të arta duke u mburrur me veprat edhe me shërbimet e tij të paçmuara që ka sjellë mbi altarin e atdheut”.

LITERATURA

- Cakolli, F. (2003). *Kodi Biblik në letërsinë shqiptare 1492 - 1947*, Tenda, Prishtinë.
- Grup autorësh, (1983). *Historia e letërsisë shqiptare- Që nga fillimet deri te lufta antifashiste nacional çlirimtare*, Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.
- Grup autorësh, (2017). *Libri shqip dhe veprimtaria protestante – 200 vjet rrugëtim kulturor*, IAPS, Tiranë.
- Hosaflook, D. (2018). *Lëvizja protestante te shqiptarët (1816 – 1908)*, ISShP, Tiranë.
- Jacques, E. (1995). *Shqiptarët – Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Lajmi i mirë, Tiranë.
- Luarasi, S. (1962). *Les soeurs Qiriaz – Hommage à l'occasion du 50^e anniversaire de la Proclamation de l'indépendance de l'Albanie (1912-1962)*, Tiranë.
- Luarasi, S. (1968). *Gjasim Qiriaz – Jeta dhe vepra*, Naim Frashëri, Tiranë.
- Lloshi, Xh. (2015). *Psalmet toskërisht dhe gegërisht Kostandin Kristoforidhi*, Shoqëria biblike ndërkonfesionale e Shqipërisë, Tiranë.
- Lloshi, Xh. (2016). *“Agimi i qytetërimit për gruan shqiptare”*, 23 tetor, 2016, Kumtesa e prof.dr. Xhevat Lloshi në rastin e përvjetorit të 125-të të themelimit të Shkollës së Vashave.
- Stucky, D. & Hosaflook, D. (2016). *Jeta ime – jetëshkrimi i pabotuar i “Mësueses së Popullit” Sevasti Qiriaz-Dako*, ISShP, Tiranë.